



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 144, datë 11.3.2022

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RIKONSTRUKSIONIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT
DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT),
NË BASHKITË SHIJAK, KRUIJË, KAVAJË, KAMZË DHE MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 489 472 928 (katërqind e tetëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e njëzet e tetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime në bashkitë Shijak, Krujë, Kavajë, Kamzë dhe Mirditë, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 247 352 928 (dyqind e dyzet e shtatë milionë e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e njëzet e tetë) lekë pa TVSH;

- b) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 16 350 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH;
 - c) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi, në masën 184 300 000 (njëqind e tetëdhjetë e katër milionë e treqind mijë) lekë pa TVSH;
 - ç) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 12 540 000 (dymbëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH;
 - d) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi në masën 28 930 000 (njëzet e tetë milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH.
2. Efekti financiar do të përballohet nga pjesa e financuar nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe t'i transferohet bashkive Shijak, Krujë, Kavajë, Kamzë dhe Mirditë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe njësi banimi në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime.
3. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Shijak, Krujë, Kavajë, Kamzë dhe Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT.1400/1
DATË 11.3 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKIVE SHIJAK, KRUJË, KAVAJË, KAMZË DHE
MIRDITË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

